



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I MONUMENTEVE TE KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

---

Nr. 4 prot

Tiranë më 22.04.2005

VENDIM

Nr. 3 Dt. 21.04.2005

PËR

MIRATIMIN E TESTIMIT TË SHOQËRIVE TË NDËRTIMIT, QË  
KANË BËRË KËRKESË PËR MARRJEN E LEJES PËR  
RESTAURIM VEPRASH ARKTITEKTURE.

Në mbështetje të Ligjit 9048, dt. 07.04.2003, "Për trashëgiminë kulturore", neni 17, si edhe të vendimit nr. 9 të KKR, dt. 14.06.2004, "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave administrative për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit të restauratorit në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe leje të shoqërive të ndërtimit për restaurim veprash arti, KKR, shqyrtoi dokumentacionin e shoqërive të ndërtimit, që kanë paraqitur kërkesë për t'u paisur me leje për restaurim veprash arkitekture, mbështetur në tabelën e dokumentacionit, bashkëngjitur këtij vendimi, konstatoi se:

1.- Në testim u paraqitën dokumenta nga shoqëritë e mëposhtme:

- "Gjiguria"
- "Genred"

2. – Pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit rezultoi se:  
plotësojnë kriteret shoqëritë e mëposhtme:

- "Gjiguria"
- "Genred"

Për këtë arsye këshilli Kombëtar i Restaurimeve,

**V E N D O S I :**

Të paisë me leje për restaurim veprash arkitekturore, shoqëritë e mëposhtëme:

- “Gjiguria”
- “Genred”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

**BLENDI KLOSI**

**KRYETAR**

**SEKRETARE**

**Edlira CAUSHI**

